**Tirane, me 12 Mars 2019**

## KOMUNIKATE PER SHTYP nga Pronari ALEKSANDER GAVOCI

### I. RRETHANA DHE FAKTE

Une Aleksander Gavoci trashegimtar ligjor i te ndjerit Ali Rexhep Rizai ne cilesine e pronarit te ligjshem te pronave te blera ne baze te ligjit te kohes te cilat jane regjistruar, transkiptuar, sekuestruar, shpronesuar e kthyer sipas ndryshimeve legjislative nder vite, ju paraqes sa me poshte historikun e pronave mbeshtetur ne

***DOKUMENTACIONIN LIGJOR***

1. Pronat jane blere ne baze te aktit publik nr 1806I te repertorit ne zyren e Ipotekave Nr.374 dt 7 Gusht 1936 jane nga Ali Rizai ne vleren 1837 franga ari me total **siperfaqe 7351 m2** perbere nga tre parcela ne fjale e para ka nje siperfaqe prej 5594 m2 , e dyta ka nje siperfaqe prej 1150 m2 dhe e treta 607m2 toka ndodhur ne katundin Sauk ( Tirane e re) – si vertetohet nga Akt i Noterit Publik date 8.8.1939. Gjithashtu ne vitin 1937 eshte blere toke me siperfaqe 2500 m2 me akt Ipotekor nr.716 date 16 nentor 2937 ndodhur ne lagjen Tirane e re.

2. Ne 21 gusht 1939 jane sekuestruar nga qeveria asokohe me Dekret te Ministrit te Drejtesise nr.56 sekuestrim i pronave te paluajteshme te Ali Rizajt ne Qarkun Tirane, konkretisht:

i. Toke+ i ndodhur ne katundin Sauk ( Tirane e re) me siperfaqe 7351.50m2 regjistruar me nr 374 dt 07-08-1936
ii. Toke e ndodhur ne lagjen Tirane e re, siperfaqe 2500 m2;
iii. Toke i ndodhur ne lagjen "Tirana e re "- siperfaqe prej 800 m2 regjistrua me nr 65 dt 16-09-1932.

*Si vertetohet nga Transkripti i dates 29 gusht 1939 Nr 663 sekuestrimi nga qeveria asokohe bashkelidhur ketu.

3. Me tej ne vitin 1944 keto prona jane kthyer.; Sipas Notes leshuar nga Zyra e Ipotekes Tirane – Nr 273- dt 17-02-1944 –deklarohet i abroguem Dekret ligja dt 21 gusht-1939 – mbi konfiskimin e pasurive duke u urdheruar kthimi i tyre zotnuesve te figuruar ne dekretin e sekuestrimit, dhe konretisht dhe pasurite e regjistruar ne zyren e Ipotekave Nr.374 dt 7 Gusht 1936 me siperfaqe 7351.50 m2 dhe pasurite me Nr. 716 date 16 nentor 2937 me siperfaqe 2500 m2.

* kthimi i pronave pronarit vertetohet dhe nga nje sere dokumentash te tjere, sic eshte pagesa e tatimit mbi ndertesat dhe token ne Tirane te vitit 1942 – sipas Shtojce -11- te " Protokoll vertetim te tatimit mbi ndertesen dhe toke te ndertimeve te qytetit te tiranes per ushtrimin 1941/1942 te leshuar nga Prefekti Qazim Mulleti.

4. Me tej ne vitin 1949 keto prona jane sekuestruar nga shteti komunist, sipas Dekretit Nr 58 dt 06-01-1949 leshuar nga Ministria e Financave me ane te se ciles eshte proceduar me shtetizim te pasurise se Ali Rizai, bllokimin e pasurise se tij, kalimin e kesaj pasurie ne favor te shtetit.

Shqiptarja.com

* si verehet nga lista e pronave te sekuestruara gjate regjimit kane qene pronat sa me siper, madje ne token me siperfaqe 7351.50 m2 objekt konflikti aktual, kane qene dhe 2 shtepi ekzistuese dhe nuk eshte e vertete qe kane qene prona te ndertuara me tej nga shteti.

5. Pas ndryshimit te regjimit, si vepruar per te gjithe pronaret, Komisioni i Kthimit te Pronave vendosi me ane te Vendimit nr.373 date 19.12.1995 njohjen, kthimin, kompensimin sipas ligjes, trashegimtareve ligjore te Ali Rizai pronat e cituara ne kete vendim ( mes tyre dhe prona e ndodhur ne L- Sami Frasheri e konkretisht siperfaqja 7351,5 m2 – truall i zene nga godina banim 1kt mbi te cilin jane cituar si ndertuar banesa shteterore 1kt) si dhe prona truall me siperfaqe 2500 m2.

Persa me lart permes dokumentacionit te sipercituar pasqyrohet fakti i origjines se pronave te Ali Rizai blere ne 1936, sekuestrimi ne vitin 1939, kthimin ne vitin 1944 dhe me tej shtetetizimi 1949 dhe serish kthimin ne 1995.

***SIUTATA AKTUALE***

Pavaresisht se familjet Llapaj dhe Dervishi po perdorin ne keqbesim pronen time si dhe te gjitha siperfaqet perreth (te cilat duhet ti lirojne dhe dorezojne sipas vendimeve te gjykatave listuar me poshte), Ne iu kemi ofruar si familje:

- ✓ Siperfaqe banimi per te gjitha familjet dhe vlere monetare gjithashtu per secilen familje prej 150'000 euro.

Edhe pse disponojme te gjitha te drejtat, ne kemi hyre ne negociata dhe firmosur akte vit pas viti ku kemi pasqyruar vullnetin e mire dhe anen njerezore per ti ndihmuar keto familje, te cilat mua si pronar me kane demtuar, por nga krahu i tyre jane demtuar nga shteti asokohe duke blere prona pa te drejte.

Konkretisht kemi vijuar me:

- Kontrate sipermarrje noteriale me Nr 2739 rep, nr 1097 kol dt 11-05-2015
- Kontrate sipermarrje noteriale me Nr 2898 rep, nr 1160 kol dt 18-05-2015
- Kontrate sipermarrje noteriale me Nr 2901 rep, nr 1161 kol dt 18-05-2015

Pavaresisht se keto kontrata nuk jane respektuar nga familjaret Llapaj dhe Dervishi, edhe me tej duke qene se pronat nuk jane liruar ne rruge zyrtare shkresore i kemi ftuar per bashkepunim (cituar me poshte), pavaresisht se une si pronar ende nuk po gezoj pronen time:

1. Shkrese ftese date 01-08-2017
2. Shkrese ftese date 08-09-2017
3. Ftese per negocim date 11-09-2017
4. Njoftim per pjesmarrje ne takim per negocim dt 19-09-2017
5. Ftese per negocim date 23-09-2017
6. Njoftim per Pjemarrje ne takim date 27-09-2017

**Pavaresisht se kam bere te gjitha perpjekjet maksimale, pavaresisht se jam pale e demtuar prej me shume se 24 vite (nga data kur pronat me jane kthyer), edhe pse iu kam ofruar nga ana njerezore siperfaqe banimi ne zone se bashku me shperblim monetar per secilin prej 150'000 euro, familjet Llapaj dhe Dervishi nuk pranojne te lirojne dhe dorezojne pronen.**

[shqiptarja.com]

**Ju terheq vemendjen se keto familje thjesht nuk duan te me lirojne pronen dhe sillen ne kete menyre vetem per interesa personale, pasi nuk eshte e vertete se keto familje nuk iu eshte ofruar ndihma nga mua dhe nuk eshte e vertete se po dalin ne rruge. Aktualisht jane pronar te nje vile 2 kateshe ne Qesarake sipas fotove me poshte.**



Ne perfundim dua te pyes ju dhe kedo, pasi une iu kam kerkuar te me lirojne pronen qe me takon dhe iu kam ofruar banesa bashke me vlere monetare per secilin, edhe pse kane vile tjeter ku mund te banojne- **A kane te drejte morale familja Llapaj dhe Dervishi te shpifi dhe mashtroje?**

**Une si pronar, qytetar dhe familjar mendoj se Jo, dhe veprat qe ato po kryejne jane ne shkelje te Kodit Penal dhe Moral mbi te gjitha.**

[shqiptarja.com]

## *HISTORIKU GJYQESOR LIDHUR ME PRONEN OBJEKT GJYKIMI*

Mes familjesve " Llapaj & Dervishaj" dhe trashegimtareve ligjore te Z. Ali Rexhep Rizai jane zhvilluar konflikte te ndryshme gjyqesore lidhur me pronen objekt gjykimi te cilat po i citojme si me poshte vijon. I gjithe dokumentacioni mund tu vihet ne dispozicion me kerkesen tuaj.

1. Vendim nr 6872 dt 27-07-2009 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, padites Ramazan Dervishi, etj, paditur Aleksander Gavoci etj, objekt-Konstatimin pjeserisht i pavlefshem i vendimit te K.K.Pronave nr 373-Tirane . Fshirjen e regjistrimit nga ZRPP – te pasurive . Nga ana e Gjykates eshte proceduar me Rrezimin e Padise.
2. Vendim Nr 2194 dt 24-11-2010 i Gjykates Apelit Tirane i cili ka lene ne fuqi vendimin nr 6872 dt 27-07-2009 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane
3. Vendim Nr 00-2011-1572 dt 12-10-2011 i Gjykates se Larte Tirane i cili ka vendosur „ Mospranim te rekursit te paraqitur kunder vendimit Nr 2194 24-11-2010 i Gjykates Apelit Tirane
4. Vendim nr 12910 dt 23-12-2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, padites Aleksander Gavoci etj kunder Ramazan Dervishi, etj, objekt-Lirim Dorezim trualli/ Pushim Cenimi/ kerkim te ardhurash per perdorim sendi. Nga ana e Gjykates eshte proceduar me Pranimin e padise, detyrim e te paditurve per lirim.., prishjen e ndertimeve pa leje te realizuara nga ana e tyre...pagim per perdorim sendi.
5. Vendim Nr 3891 dt 01-12-2014 i Gjykates Apelit Tirane i cili ka lene ne fuqi vendimin nr 12910 dt 23-12-2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
6. Vendim Nr 909 akti „ Leshim urdher ekzekutimi" per vendimin nr 12910 dt 23-12-2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, lene ne fuqi me vendimin Nr 3891 dt 01-12-2014 i Gjykates Apelit Tirane.

Nga ana e shtetasit Aleksander Gavoci kane filluar procedurat permbarimore, per ekzekutimin e vendimit Nr 12910/2013 lene ne fuqi me vendimin nr 3891/2015, por se nga ana e tij njekohesisht eshte propozuar dhe negociuar per te proceduar me marrveshje mes paleve ne konflite duke lidhur kontrata sipermarrje me familjen Llapaj dhe Dervishaj ( te cilat do ti pasqyrojme me vone te rubrika – propozim marrveshjesh) . Nga ana e familjen Llapaj dhe Dervishaj jane shkelur kushtet e marrveshjes dhe kane proceduar me padi te tjera gjyqesore ne menyre te padrejte e konkretisht:

1. Padi me pale padites : Ramazan Dervishi etj, kunder Aleksander Gavoci etj, Z.Permbarimit, objekt – Pavlefshmeri titulli ekzekutiv( 12910)/ Kundershtim veprimesh permbarimore i cili ka vendosur pranimin e pjesshem te padise, Pavlefshmerine e titullit ekzekutiv, pezullimin e veprimeve permbarimore. Referuar Vendim Nr 834 dt 02-02-2018 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte vendosur pranimi i padise.
2. Kunder ketij venimi eshte bere ankim dhe referuar Vendim Nr 1026 dt 19-07-2018 i Gjykates se Apelit Tirane, eshte vendosur „ Ndryshimin e vendimit Nr 834 dt 02-02-2018 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Rrezimin e kerkese padise.
3. Rekurs civil dt 31-07-2018 kunder vendimit Nr 1026 dt 19-07-2018 i Gjykates se Apelit Tirane te familjes Llapaj & Dervishaj.
4. Kunder Rekurs – dt 28-09-2018 i Ilir Gavoci.
5. Kerkese e parqitur nga familja „ Llapaj dhe Dervishaj - kunder Aleksander Gavoci etj- Objekt – Rishikim vendimit nr 12910 dt 23-12-2013 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, lene ne fuqi me vendimin nr 3891 dt 01-12-2014 te Gjykates se Apelit Tirane. Referuar Vendim Nr 80 dt 30-01-2019 te Gjykates se Apelit Tirane- eshte vendosur rrezimi i kerkesese se paraqitur nga ana e tyre duke lene ne fuqi vendimit e sipercituar .

[shqiptarja.com]

Persa me lart nga ana e ime eshte propozuar vazhdimisht per bashkpunim, negocim, etj edhe pse jam pronar i prones ku ato banojne

***Njekohesisht theksoj qe ekzekutimi i vendimit ne te cilin une kam fituar sipas ligjit, nuk ka te beje me nxjerrjen jashte nga banesa e tyre, por vetem me prishjen e shtesave pa leje ashtu sic eshte vendosur ne vendimin 12910 /2013 te cilet po e citojme si me poshte vijon :***

- ***Detyrimin e te paditurve, Fatime Dervishi, Ramazan Dervishi, Ramiz Dervishi dhe Sinan Dervishi, te prishin me shpenzimet e tyre ndertimet mbi katin perdhe te baneses se tyre te ndodur ne Tirane, Rruga " Sami Frasheri "pallati nr 33, Shk 1, kati pare , me siperfaqe 107.30 m/2 .***
- ***Detyrimin e te paditurve , Agron Llapi, Bukurije Llapi , Dhurata Llapi dhe Luan LlApi , te prishin me shpenzimet e tyre, ndertimet mbi katin perdhe te baneses se tyre te ndodur ne Tirane Rruga " Sami Frasheri " pallati nr 33, Shk 1, kati pare , me siperfaqe 116 m/2***

Persa me lart, nuk qendrojne asnje nga pretendimet e tyre persa i takon origjines se prones sime, vijueshmerise se saj, mungeses se dokumentacionit, apo marrveshjeve negociuese mes nesh
Sqaroj se pale e demtuar ne kete rast, pas gjithe ofertave qe u kam propozuar per bashkepunim duke siguruar dhe strehimin e tyre , jam vetem une, ndaj te cilit eshte shpifur dhe eshte pergenjeshtruar per te verteten duke u bere dhe mashtrim mediatik dhe masmedia , fakt per te cilin do te kerkoj nderhyrjen e organeve kopetente duke e lene per zgjidhje organeve te drejtesise

***ALEKSANDER GAVOCI***

[shqiptarja.com]

1

MUMTAZ KOKALARI
NOTER PUBLIK
TIRANE

DREJTORIA E PERGJITHESHME E ARKIVAVE TE SHTETIT

Aktet qe jane kryer ne kete Zyre prej Familjes se Ali Rizait.

Ne baze t'aktit publik me Nr.18601 te repertorit, date njembedhjete Qershor njemije nendeqinde tridhjet e gjashte, transkriptuar ne zyren e ipotekave te Tiranes nene Nr.374, date 7 Gusht 1936, zoti Leonidha Nishku i te ndyerit Jovan, lindur e banues ne Tirane i ka shitur Ali Rizait tri parcela toke qe i shkeput nga toka e tije me emer Idhnaqe, ndodhur ne Katundin Selite te Tiranes. Nga tri parcellat ne fjale e para ka nji siperfaqe 5594 metra kare, e dyta 1150 metra kare dhe e treta gjashteqind e shtate metra kare, toka te cilat duke qene puqe njera me tjeteren formojne nji blok me vehte, me siperfaqe komplesive shtatemije treqind e pesedhjet e nji metra katrore e pesedhjete centimetra, kufizuar nga Lindja me token qe i ngel disponibel shitsit nga perendimi pjeserisht me shitsin e pjeserisht me Said Kosoven, nga Veriu me rrugen e Lullinit dhe e nga juge ma Muhamed Pelinkun. Shitja u be per franga ari 1837, te paguara plotesisht.

7351 m²

V E R T E T O H E T

Tirane, me 8.8.1939.

Noter Publik:

MUMTAZ KOKALARI I BIRI RESHATIT NOTER PUBLIK TIRANE

A.Q.SH F.255 V.1938 D.608/3 f.225

[shqiptarja.com]

...dorë mbi pronën e përshkrueme në këtë dekret, dhe Zyrën e Ipothekave të Tiranës me transkriptue sekuestrimin e bamë.

Ky Dekret, për të gjitha efektet e ligjës, do të botohet në Fletoren Zyrtare të Mbretnis.

Tiranë, me 21 Gusht 1939 XVII

Ministri i Drejtësis
Xhafer Ypi d. v.

---

*Dekret i Ministrit të Drejtësis*
*21 Gusht 1939-XVII, Nr. 55*

## Sekuestrim i pasunis së Hava Vasjarit

# Dekret

Ministri Sekretar Shteti për Dretësiën,

Mbassi shqyrtoj proces-verbalin e Komisionit të posaçëm datë 17 Korrik 1939-XVII, me të cilin proponohet sekuestrimi i pasunis së lujtëshme e të pa lujtëshme të pjestarëve të familjes së Veli Abedin Vasjari, nga Korça, tash me banim të pa-dijtun;

Tue marrë parasysh se konkurojnë të gjitha ekstremet e lypuna prej dekret ligjës me datë 2 Qershuer 1939-XVII;

Në bazë të nenit 2 t'atij dekret-ligji;

DEKRETON

Sekuestrimin e pasunis së pa-lujtëshme të Hava Vasjarit, bashkë-shorte e Veli Abedin Vasjarit, që ndodhet në qarkun e Tiranës e që simbas Vërtetimit të lëshuem me Nr. 381/III datë 5.8.1939 XVII prej Zyrës Ipothekavet të Tiranës, përbahet prej: Një shtëpi e ndodhun në lagjen Abdulla ... të Tiranës, e përbame prej dy oda nalt, nji korridor, një gjelltore, oborr e pjesë pusi, rregjistrue me Nr. 214 datë 1.4.1932, kufizue: Lindje, ... ball 10 metra me rrugë. Perendim, me dy ball... njani prej 2.30 metra e tjetri 7.70 metra, me trashigimtarët e Hysen Kukaleshit. Veri, me nji ... prej 15-16 metra me Hamid Koçi. Jugë, dy ... njani prej 3.65 metra me trashigimtarët e ... e Ali Kukaleshi, me të drejtë me mbushë

Urdhënon Zyrën e Financavet të Tiranës, me vue dorë mbi tokën dhe ndërtesën e përshkrueme në këtë dekret, dhe Zyrën e Ipothekavet të Tiranës me transkriptue sekuestrimin e bamë.

Ky Dekret, për të gjitha efektet e ligjës, do të botohet në Fletoren Zyrtare të Mbretnis.

Tiranë, me 21 Gusht 1939-XVII.

Ministri i Drejtësiës
Xhafer Ypi d. v.

---

*Dekret i Ministrit të Drejtësis*
*21 Gusht 1939 XVII Nr. 56*

## Sekuestrim i pasunis së pa-luejtëshme të Ali Rexhep Rizajt

# Dekret

Ministri Sekretar Shteti për Dretësinë,

Mbasi shqyrtoj proces-verbalin e Komisjonit të posaçëm datë 17 Korrik 1939-XVII, me të cilin proponohet sekuestrimi i pasunisë së luejtëshme e të pa-luejtëshme të Ali Rexhep Rizajt, nga Kosova e tash me banim të pa-dijtun;

Tue marrë parasysh se konkurojnë të gjitha ekstremet e lypuna prej dekret-ligjës me datë 2 Qershuer 1939 XVII;

Në bazë të nenit 2 t'atij dekret-ligji;

DEKRETON

Sekuestrimin e pasunis së pa-luejtëshme të Ali Rexhep Rizajt që ndodhet në qarkun e Tiranës e që simbas Vërtetimit të lëshuem me Nr. 381-IV datë 5-8 1939-XVII prej Zyrës Ipothekavet të Tiranës, përbahet prej pronave të posht-sherjueme.

1. Nji truell i ndodhun në Lagjën Tirana e Ré, me sipërfaqe prej 800 (tetqind) metra katrore, regjistrue me Nr. 65 datë 16. 9. 1932, kufizue: Lindje, Kol Dhimitri. Perendim, Rrugë. Veri. Qazim Zyma. Jugë, Hysen Selmani, si edhe ndertesa e ngrehun mbi at truell që vërtetohet me Deklaratën e lëshueme prej Kryeplakut të lagjes së Ré datë 8. 8. 1939, por që nuk asht e rregjistrueme në zyrën e Ipotekavet;

[shqiptarja.com]

2. Një tokë e ndodhun në katundin Saud (Tirana e Ré) me sipër-faqe prej 7351.50 (shtatmij e treqind e pesdhjet e nji e 50 0/0) metra katrore, rregjistrue me Nr. 374 datë 7. 8. 1936, kufizue: Lindje, Leonidha Nishku. Veri, Rruga e Mullinit. Jugë, Muhamet Pelniku;

3 Një tokë e ndodhun po në lagjen Tirana e Ré, me sipërfaqe prej 2500 (dymij e pesqind) metra katrore në formë tri kandëshi, rregjistrue me Nr. 716 datë 17. XI. 1937, kufizue: Lindje, Marija Gjoni, Seihat Lumani e Ali Rizaj. Veri, Rrugë. Jugë, Mahmud Pelniku.

Urdhënon Zyrën e Financavet të Tiranës me vue dorë mbi pronat e ndertesën e përshkrueme në këtë dekret, si dhe Zyrën e Ipothekavet të të Tiranës, me transkriptue sekuestrimin e bamë.

Ky Dekret, për të gjitha efektet e ligjës, do të botohet në Fletoren Zyrtare të Mbretnis.

Tiranë, me 21 Gusht 1939-XVII.

Ministri i Drejtësiës
Xh. Ypi d. v.

---

*Dekret i Ministrit të Drejtësis d. 22 Gusht 1939-XVII Nr. 57*

## Sekuestrim i pasunis së Faik Shatkut

## Dekret

Ministri Sekretar Shteti për Drejtësiën,

Mbassi shqyrtoi proces-verbalin e Komisionit

5.8.1939-XVII prej Zyrës Ipothekavet të Tiranës, përbahet prej pronave të posht-shenjueme:

1. Një tokë e ndodhun në lagjen Tirana e Ré, me sipër-faqe prej 1100 (njimij e njiqind) metra katrore, me Nr. 129 të planit, rregjistrue me Nr. 1102/110 datë 28.9.1928, kufizue: Lindje, Rruga XII. Perëndim, Nr. 131. Jugë, Rruga XXV;

2. Një truell po në lagjen Tirana e Ré, me sipër faqe prej 163.75 (njind e gjashtdhiet e tri e 75) metra katrore, rregjistrue me Nr. 687 datë 22.9.1938 kufizue: Me qi asht ngjitun me truellin e shennem në Nr. 1, me Nr. 175 e 129 të planit, me bulevard Telini.

Urdhënon Zyrën e Financavet të Tiranës, me vue dorë mbi pronat e përshkrueme në këtë dekret, dhe Zyrën e Ipothekavet të Tiranës me transkriptue sekuestrimin e bamë.

Ky Dekret, për të gjitha efektet e ligjës, do të botohet në Fletoren Zyrtare të Mbretnis.

Tiranë, me 22 Gusht 1939-XVII

Ministri i Drejtësiës
Xhafer Ypi d. v.

---

*Dekret i Ministrit të Drejtësis d. 22 Gusht 1939-XVII, Nr. 58*

## Sekuestrim i pasunis së Sotir Martinit

## Dekret

Ministri Sekretar Shteti për Drejtësiën,

Mbassi shqyrtoi proces-verbalin e Komisionit



5. 8. 1939-XVII prej Zyr
përbahet prej pronavet të
1. Një copë tokë
Nr. 151 datë 20. 5 1933
dullah Bej të Tiranës, k
Murati. Djathtas Shaban
pa Shaban Fagu;
2. Nji truell, po n
prej 180 (njiqind e tetdh
e 14 (katërmbëdhjetë) me
me Nr. 322 datë 31. 7. 19
tarak, toka e vet (Sotir
Vathi e Xhade, prej tre e
3. Një ndërtesë të ri
e cila vërtetohot me dek
datë 8. 8. 1939, prej Krye
llah Bej të Tiranës, por
me në zyrën e Ipothekave
Urdhënon Zyrën e F
vue dorë mbi pronat dhe
në këtë dekret, dhe Zyrën
me transkriptue sekuestrin
Ky Dekret, për të gjith
botohet në Fletoren Zyrtar
Tiranë, me 22 Gusht 1

---

*Dekret i Ministrit të D*
*1939-XVII*

## Sekuestrim i Allaman

... SHQIPTARE
...potekave

Note Transkriptimi

ne favor te

Mbretnis Shqiptare.................

kundra

Ali Rexhep Rizajt, nga Kosova, tash me banim te paditur....

Ne baze te Dekretit te Ministris se Drejtesis me Nr. 56 date 21.8.1939.XVII, per efektet e ligjes kerkohet pasunia e Ali Rizajt qe te sekuestrohet, e cila perbahet:

1) Nji truell i ndodhur ne lagjen Tirana e Re, me siperfaqe prej 800 metra katrore, pregjistrue me Nr.65 date 16.9.1932 kufizue: L.Kol Dhimitri, P.rruge, V.Qazim Zyma e J.Hysen Selmani, sidhe ndertesa e ngrehur mbi ate truell qe vertetohet me deklaraten e leshueme prej Kryeplakut te lagjes se Re D. 8.8.39 por qi nuk ashte e rregjistrueme ne kete zyre.

2) Nji toke e ndodhur ne katundin Sauk (Tirana e Re) me siperfaqe prej 7351,50 metra katrore, kufizue: L.Leonidhe Nishku, P.Leonidhe Nishku, V.rruga e Mullirit e J.Muhamet Pelniku

3) Nji toke e ndodhur po ne lagjen Tirane e Re, me siperfaqe prej 2500 metra katrore ne forme trekandeshi, rregjistrue me Nr.716 date 16.XI.1937, kufizue: L.Marija Gjoni, Seihat Lumani e Ali Rizaj, V.rruge, J.Mahmud Pelniku. Toka shenue ne Nr.II. ashte e rregjistrue me Nr.374 date 7.8.36........

Tirane, me 29 Gusht 1939 XVII.

NËNPUNSI I IPOTEKAVE

[shqiptarja.com]

Shteti Shqiptare
Zyra e Permbarimit Tiranes
Nr. 273 Aktit

36

(3)

1.5.44

## Kerkese-Notimi

Kryesia e permbarimit duke u mbeshtet ne dispozitat e urdheneses te Kryesis Komitetit Eksekutiv te Perkoheshem Nr.29 date 16.X.943, qe deklarojne te abroguem Dekret Ligjen date 2.6.1939, mbi konfiskimin e pasunive dhe te anulluara çdo disponim ose jetersim te ma pasëm mbi keto pasunie duke u urdhenuare kthimi i tyne zotnuesave te ma pareshem te figuruar ne Dekretin e Sekuestrimit, me Vendimin e vet Nr. 272 date 17/4/44, ka vendosur ngritjen e sekuestrimit te vuem me Dekretin e Ministris Drejtesies Nr.56 date 21.8.939, Transkiptue ne Zyren e Ipotekave me Nr.663 date 29.8.939, mbi dy cope prona te ndodhura ne lagjen e Re te Kryeqytetit e te Transkiptuara ne regjistrat Ipotekore ne Nr.374 date 7.3.936, e Nr.716 date 16.11.1937. te Z.Ali Rizajt

Prandaj lutemi te kryhet notimi i nevojshme.

Tirane, me 17/4/ 944.

Kerkuesi
Nepunesi i Permbarimit
( D.Pogoni)

7-46
9.3

Notim 285
34

Aldi u bodhet
Cidhe Nr. 161. D. 1.5.44

74)

SHTOJÇE e 11 të

I Protokoll-Vërtetimit të Tatimit mbi ndërtesa dhe Tok ndërtimeve të qytetit të Tiranës për ushtrimin 1941/42.

| Nr. | Emni e mbiemni | Tatimi Fr.Shq. | 2% Arsim Fr.Shq. | Shuma Fr.Shq. |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Sotir Martini | 195.- | 3.90 | 198.90 |
| 2. | Servete Fiqri Rusi | 37.50 | 0.75 | 38.25 |
| 3. | Taf Kaziu | 110.- | 2.20 | 112.20 |
| 4. | Pallati i Prinçesavet | 1000.- | 20.- | 1020.- |
| 5. | Zonja Sanije Z0gu | 353.30 | 7.06 | 360.36 |
| 6. | Xhemal Ferra | 5.30 | 0.10 | 5.40 |
| 7. | Qemal Jusufati | 215.- | 4.30 | 219.30 |
| 8. | Kostaq Kota | 170.- | 3.40 | 173.40 |
| 9. | Xhemal Araniti | 150.- | 3.- | 153.- |
| 10. | Ali Riza | 60.- | 1.20 | 61.20 |
| 11. | Martin Jovani | 110.8 | 2.20 | 112.20 |
| 12. | Xhelal Zogu | 200.- | 4.- | 204.- |
| 13. | Inajet Delvina | 65.- | 1.30 | 66.30 |
| 14. | Seadet Musa Juka | 240.- | 4.80 | 244.80 |
| 15. | Zonja Adile Zogu | 309.- | 6.18 | 315.18 |
| 16. | Trashg.e Dr.Simonidhit | 30.75 | 0.61 | 31.36 |
| | Shuma | 3250.85 | 65.- | 3315.85 |

Vërtetohet se këjo shtojcë e dytë e Protokoll-Vërtetimit të Tatimit mbi ndertesa dhe tokë ndërtimevet për vjetin 1941/42 kap shumën Fr. Shq.3250.85% plus 2% Arsim Fr.Shq.65,gjithsejt shuma Fr.Shq.3315.85%(tremijetre=qindepesmbëdhjet e 85%).

p.Nëp.Tat.Direkte Seks.B.:
(Tahsin Dobi).

Drejtor'i Financës:
(Dhionis Xhavara)

V ë r t e t o h e t:

P r e f e k t i:
(Qazim Mulleti)

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE TË SHTETIT

[shqiptarja.com]

120

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

V.F. – [illegible]
Tiranë, më 6. I. 19[illegible].-

PULLE TAKSE 100 LEKE SHQIPERISE

(4)

## DEKRET MINISTERIAL

Nr. 58 dt. 6. I. 949

Ministri i Financave, pasi pa vendimin e Komitetit Ekzekutiv të K.P. të Qytetit të Tiranës nr. 390 dt. 15. I. 947, me të cilën propozohet shtetëzimi i pasuris së Z. Ali Rizaj ..................................

Pasi shqyrtoj dosjen përkatëse nga e cila rezulton se konkurojnë të gjitha ekstremet e parapara nga ligja nr. 353 dt. [illegible].XI.1946, mbi kontrollimin e pasurive të vëna gjatë rregjimeve të kaluara prej funksionarëve dhe sipërmarrësave të Shtetit.-

Në mbështetje të nenevе [illegible] e 4 të kësaj ligje;

## DEKRETON:

1) Shtetëzimin e pasurisë së pa-tundëshme të Z. Ali Rizaj ........................, sikundër tregohet në vendimin e sipërmë të Komitetit Ekzekutiv të KP. të Qytetit të Tiranës;

~~2) Shtetëzimin e pjesës së pasurisë [illegible] e domosdoshme për jetesën e Z. .................................... dhe të familjes së tij të ngushtë;~~

3) Kalimin e kësaj pasurije në favor të Shtetit, të lirë nga çdo barë që mundë të rëndojë mbi të.-

4) Ky dekret hyn në fuqi qysh nga data e blokimit të pasurisë.-

MINISTRI
[signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE
Nr. 120 Rep.
Dt. 08/08/199[illegible]
VERTETIM
Vertetohet njesia me origjinalin.
Nxjerre nga
U paraqit nga Aleksander Gorogi
Shenime
NOTERE
ENKELEIDA HOXHA

F. 1005   V. 1949   [illegible]

[shqiptarja.com]

4

DREJTORIA E PERGJITHESHME E ARKIVAVE TE SHTETIT

# LISTA E PASUNIVE TË PA TUNDËSHME SEKUESTRUE E KONFISKUE QË NDODHEN NË LAGJEN TIRANË E RE

| Nr. Rend | Emni e mbiemni i ish pronarit | Lloji | Përshkrimi i pasunis | Emni e mbiemni i personit që e ka në dorezim | Vrejtje |
|---|---|---|---|---|---|
| 18 | Ali Riza | 1 shtëpi | ngrehun me truellin me sipërfaqe 800 m2.kufizue L.Kol Dhimitri P.rrugë V.Qazim Zyma j.H.Selmani | Major Mario Maro e familja Ali Riza. | [signature] |
| 19 | " " | 2 shtëpi e nji tokë | shtëpitë janë përdhese njena 2 kthina e njena 1, toka me sip.7351.50 m2. kuf.L.Leonidha Nishku P. Dheonidha Nishku V.rrugë e mullinit J.M.Pelniku | Iljaz Nazif | |
| 20 | " " | 1 shtëpi e nji tokë | Shtëpija me dy dhoma perdhese,toka me sip.2500 m2 kuf.L.Maria Gjoni,Seit Lumani e Ali Rizai, V. rrugë J.Mahmut Pelniku | Selman Mehmet Mata (tash bosh) | |
| 21 | Dr.Simon Simonidhi | 1/2 ~~shtepi~~ e nji copë vendi | me sipërfaqe 800 M2 me Nr.203/200 të planit kufizue L.e V.Rrugë,P.toka Nr.201/201 J.toka Nr.300/28. | [signature] | Pasunit e Dr. Simonidhit që fillojnë nga nr. 21 deri me nr. 24 janë vetëm ... |
| 22 | " " " | 1/2 ~~shtepi~~ e nji copë vendi | 1290 m2 me Nr.28 të planit kufizue L.Bulevard A.F.Dr.Simonidhi,J.Shteti,V.Rruga Elbasanit | | |
| 23 | " " " | 1/2 e nji copë vendi | 81.80 m2 kufizue nji anë rruga Elbasanit nji anë toka Nr.41/269,nji anë toka Nr.220/264 nji anë Dr.Simonidhi e rruga që do çelet | | |
| 24 | " " " | 1/2 e nji copë vendi | me sipërfaqe 42 m2 kufizue tri anë rrugë e nji anë Dr.S.Simonidhi | | |
| 25 | " " " | 1/2 e nji copë vendi | 650 m2,kuf.L.e P.S.Gjyshi V.S.Gjyshi e Abaz Tagani.J.S.Gjyshi,L.dhe me rrugën Elbasanit | | |

./.

AQSH F277 V1970 D170 f4.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA QYTETIT TIRANE
KOMISIONI KTHIMIT DHE KOMPESIMIT
TE PRONAVE ISH PRONAREVE
RAJONI NR.2

Nr. 373 prot. Tirane, me 19. 12. 95

# V E N D I M
Nr. 373 date 19. 12. 95
PER
KTHIMIN DHE KOMPESIMIN E PRONAVE

Komisioni kthimit dhe kompesimit te pronave ish pronareve i Bashkise qytetit Tirane sot me dt 19. 12. 95 mori ne shqyrtim kerkesen e bere nga ish pronari Ali Rizai me Nr.1940 te aktit me objekt kthimin e prones se tij te perbere nga 3 parcela tokash prej te cilave e para me sip.5594 m2, e dyta 1150 m2 dhe e treta prej 607.5 m2 toka te cilat duke qene te puqura njera me tjetren formojne nje bllok me vehte me sip.komplekse 9351.5 m2 qe kufizohet: me token qe i ngel disponibel shitesit, Perendimi me token qe i mbetet disponibel shitesit e pjeserisht me Said Kosoven, Veriu me rrugen e mullirit, dhe nga Jugu me Muhamet Pelinkun.

Prona figuron e rregjistruar ne rregjistrin Ipotekor Nr.37 dt.7.8.1936. dhe NR.716 dt.3.8.1937

K O M I S I O N I

pasi kontrolloi dokumentacionin e paraqitur nga ish pronaret konstaton se ai eshte i plote dhe konform kerkesave te ligjit 7698 dhe akteve nenligjore. Specialistet bene verifikimin ne vend dhe hartuan p-v perkates nga i cili rezultoi:

Sip. prej 9851.5 m2 eshte e zenen me:
Instutitcione:
g4-instituti Nr.3-670 m2 + g5-ndermarja gjeologji gjeodezi 449m2
+g6- godine 5 KT SHIK-ut 193 m2 1312 m2
2 - pall 4 KT+6 KT,
g7 407 m2 + g8 177 m2 +g9 352 m2 =936 m2
- sheshe te rrethuar insuticionet,
S18 513 m2 +S20 90 m2, =903 m2
- godine banimi 1 KT,
g1 86 m2 + g2 75 m2 + g3 309 m2=470 m2,
./.

Ishiptarja.com

- godine private me leje g12 = 52 m2,
- godine private, kioske pa leje = 93 m2,
g10+K13=28 m2+65 m2,

- sheshe te pa zena (te lira) S1 60 m2+S2 15 m2+ S3 85 m2 +S4 192 + S5 903 m2 + S6 103 m2 +S7 20 m2, S8 40 m2 + S9 16 m2 + S10 24 m2 + + S11 46 m2 + S12 17 m2 + S13 33 m2 + S14 320 m2 + S15 63 m2 + S16 43 m2 + S17 36 m2 = 1435 m2

- sip. e zene merruge e trotuare 4650.5 m2

GJITHSEJ 9851.5 m2

Komisioni ne baze te pikes 2/a te VKM nr.301 dt.14.06.93:

V E N D O S I

1. Te njohe Ali Rizain ish pronar te nje prone te perbere nga nje truall me sip.9851.5 m2 qe kufizohej: Lindje me token qe i ngelet disponibel shitesit, Perendimi pjeserisht me token qe i ngelet disponibel shitesit dhe pjeserisht me Said Kosoven, Veriu me rrugen e mullirit dhe Jugu me Muhamet Pelingun.

Prona kthehet ose kompesohet si me poshte:

a - truall i lire me sip.1435 m2 (sic percaktohet ne genplanin e bashkengjitur nga S1 deri S17) dhe ne baze te nenit 19 te ligjit 7698 dt.15.04.93 i njihet dhe i kthehet pronarit Ali Rizait (trashegimtareve te tij) pronesia mbi kete truall.

b - truall i zene me ndertime te perhershme (rruge, trotuare, sheshe, Nd.Gjeologji, Gjeodezi SH.I.K, Instituti Nr.3, me pallate, godina 1 KT prone private) me sip. te pergjithshme 8053.5 m2 dhe ne baze te nenit 16 te ligjit 7698 dt.15.04.93 te kompesohet pronari Ali Rizai (trashegimtaret e tij) per sip. e sipershenuar me nje nga menyrat e parashikuara ne kete nen.

Ne baze te nenit 21 te ligjit 7698 dt.15.04.93 Ali Rizai (trashegimtareve te tij) te drejten e parablerjes se objekteve Instituti Gj Gjeologji Gjeodezi me sip. (g5+S18) 1262 m2 (ku godine ze sip.749 m2) te objektit 4 kt+2 kt te institutit Nr.3 me sip.670 m2 te objektit 5 KT te SH/I/K-ut me sip.193 m2 kur ato te privatizohen me cmimet e percaktuara nga dispozitat ne fuqi.

c - truall i zene nga kioskat me sip. te pergjithshme 93 m2 g10=28 m2 dhe K13=65 m2, dhe ne baze te nenit 15 te ligjit 7698 dt.15.4.93 i njihet dhe i kthehet pronarit Ali Rizai (trashegimtareve te tij) pronesia mbi kete truall.

./.

Ishqiptarja.com

d - truall i zene nga godina banimi 1 KT (g1+g2+g3=86+75+309) me sip.470 m2 dhe ne baze te nenit 20 te ligjit 7698 dt.15.04.93 pronari i truallit Ali Rizai (trashegimtaret e tij) mbi te cilin jane ndertuar banesa shteterore 1 KT ka te drejten e bashkepronesise ne truall ne raportin 1:2 (d.m.th 200 m2). Ish pronari ka te drejten te ndertoje nje shtese kati mbi banesen , ndersa te gjitha ndryshimet e tjera te mevonshme i nenshtrohen ligjit "Per bashkepronesine ne banesa".

Prona figuron e rregjistruar ne rregjistrin Ipotekor Nr.374 dt.7.08.1936 dhe kufizohet: Lindje pall.4 KT, godina & KT (SH.I.K), sheshe etj.Perendimi godina 1 KT dhe rruge, Veriu godina 4 KT dhe rruge Jugu godina 4 KT (genplani bashkengjitur).Dherregjist.Nr.716dt 3.8.37

2. Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykaten e Rrethi Tirane.

3. Nje kopje e ketij vendimi dergohet per rregjistrim ne Ipoteke dhe ne Kadastren Urbane.

KRYETARI KOMISIONIT
LULZIM COLLAKU

[shqiptarja.com]